



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

K R Y E T A R I

Nr. 1285/6 Prot.

Tiranë, më 30 / 04 / 2017

V E N D I M

Nr. 45, Datë 30/ 04 /2017

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË TIRANË, ME OBJEKT “MBI ZBATIMIN E RREGULLSHMËRISË TË AKTIVITETIT EKONOMIK DHE FINANCIAR” PËR PERIUdhËN 01.01.2014-31.12.2016.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar” për periudhën 01.01.2014-31.12.2016”, të ushtruar në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

I. Mbi auditimin e prokurimeve publike (Argumentimet dhe përlllogaritjet e fondeve limit, analizat dhe vlerësimet e zbatimit të procedurave të prokurimit dhe i lidhjes e zbatimit të kontratave).

1. Për periudhën objekt auditimi (2014-2016) regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike nuk janë hartuar konform legjislacionit për prokurimin publik dhe konkretisht formatit standard të miratuar nga APP dhe të publikuar në faqen zyrtare të saj. Në këto kushte UMT ka konsideruar në rolin e regjistrat për parashikimet për prokurimin publik Vendimin e Këshillit të Administrimit me të cilin miratohet buxheti i konsoliduar i universitetit brenda tremujorit të parë të vitit buxhetor. Për pasojë, regjistri i parashikimit është dërguar me vonesë në MAS dhe jo brenda afatit të përcaktuar në kërkesat e Kreut I, pika 3/b, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, dhe

nenit 4/1 i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 (për prokurimet e vitit 2014-2016), si dhe nuk janë evidentuar të dhënat për blerjet/shërbimet dhe punimet blerje me vlerë të vogël veç për njësitë shpenzuese (fakultetet) dhe veç të dhënat për rektoratin e UMT.

2. Në të gjitha procedurat e prokurimit publik të audituara konstatohet se UMT ka marrë tagrin e “organit qendror blerës”, me argumentin se nuk ka staf për të realizuar këto procedura në fakultete si dhe mallrat që prokurohen janë të së njëjtës natyrë, duke mos respektuar kërkesat e nenit 11/1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, me ndryshime, VKM nr. 1, datë 10.1.2007, me ndryshime, Kreu I, pika 2/a,c dhe ç (për prokurimet e vitit 2014) dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 (për prokurimet e vitit 2015, 2016) Kreu I, neni 2/2,4. Konstatohet se UMT duke marrë përsipër këtë rol jo vetëm që ka prokuruar fondet por ka lidhur kontrata si dhe kërkuar transferimin e fondeve të njëjësive të varësisë për të kryer likuidimin e kontratave

3. Në regjistrat e realizimit të prokurimeve, janë përfshirë edhe prokurime të cilat kanë filluar para vitit raportues. Kjo mënyrë pasqyrimi në regjistrat e realizimit të prokurimeve publike nuk pasqyron realitetin dhe nuk jep të dhëna të sakta mbi realizimin vjetor të prokurimeve pasi krijon idenë se realizimet e tyre janë me kursime. Nga ana tjetër raportimet e realizimeve faktike të tenderave janë shtrirë në një periudhë kohore që përfshin dy vite kalendarike. Konkretisht prokurimi i përvitshëm me objekt “Ruajtja dhe sigurimi fizik i UMT”, ka një zgjatje të përfundimit të tij nga janari deri qershor-korrik, të vitit raportues.

4. Vlerat e fondeve limit janë prokuruar brenda vitit në disa procedura të ndryshme, por pa ndryshuar vlerat e tyre për çdo procedurë prokurimi, në një kohë që vlerat e kontratave të lidhura për këto procedura, janë korrektuar me afatet kohore, që kanë fuqi veprimi për secilën kontratë.

-Në disa raste, janë raportuar në regjistër, si realizim procedurash prokurimi edhe pagesat (likuidimet) e kryera për shpenzime të cilat nuk prokurohen të tilla si: shpenzimet për energji elektrike, ujë, telefon dhe celular; trajnime dhe seminare; honorarë, këshillat shkencor e senati; aktivitet karakterit mësimor shkencor; promovim për karrierën profesionale, për libra, botime; kuota pjesëmarrje anëtarësie; certifikimi i laboratorëve dhe departamenteve “ISO”, dokumente pronësie në hipoteka apo këshillin e qarkut, etj. të kësaj natyre. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.18-47 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

Për sa sipër rekomandoj:

-Regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike të plotësohen konform formatit standard të miratuar nga APP dhe të publikuar në faqen zyrtare të saj. Ato të dërgohen brenda afatit kohor në institucionin qendror që vë në dispozicion fondet buxhetore-Ministria e Arsimit dhe Sporteve (MAS).

-Të raportohen vetëm të dhënat që prokurohen dhe jo shpenzimet operative për të cilat nuk kryhen procedura prokurimi pasi bëhen nëpërmjet ditarit të pagesave të bankës, bazuar në LPP; VKM nr. 914, datë 29/12/2014, neni 4, pika 3 si dhe Udhëzimit të APP-së nr. 2, datë 27/01/2015, pika 6.

-Të raportohen në regjistrin e realizimit të prokurimeve ato procedura që përfundojnë brenda vitit buxhetor si dhe të raportohen në këtë regjistër si fonde limit të prokuruar konkretisht për tenderat e rojeve, vlera e korrektuar me periudhën kohore që është vendosur në kontratën e lidhur.

-Në rastin kur UMT merr përsipër rolin e “organit qendror blerës” për të kryer procedurat e prokurimit në emër të çdo AK të njëjësive vartëse (fakultetet), në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, Kreu I, neni 2/2,4, të mos tejkalohe funksionet e përcaktuara duke bërë transferimin e fondeve publike.

Çdo fillim viti

5. Në rastin e llogaritjes së fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike, komisioni i ngritur me urdhër të titullarit nuk ka pasqyruar çdo veprim në procesverbal si dhe nuk ka lënë gjurmë të përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë mbi të cilët është bërë llogaritja e fondit limit. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr. 18-47 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

Sa sipër rekomandoj:

Komisionet e ngarkuar me urdhër të titullarit për llogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike (përrjashtuar prokurimet për blerje e shërbime me vlerë të vogël), të

pasqyrojnë çdo veprim për llogaritjen e fondit limit duke analizuar shkaqet e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Menjëherë

6. Në hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim konstatohen mangësi të cilat kanë të bëjnë me vendosjen e këtyre kritereve dhe konkretisht:

Kërkesat e përgjithshme të kualifikimit sipas rregullave të prokurimit publik në fuqi, në rastin e konkurrimit të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, detyrimisht duhet të plotësohen këto kërkesa nga secili anëtar i bashkimit, ndërsa për kërkesat e veçanta kriteret plotësohen në bazë të përqindjes së punëve që ka marrë përsipër secili anëtar i grupit të këtij bashkimi sipas marrëveshjes. Dokumentacioni i lëshuar për vërtetimin e realizimit të kërkesave të përgjithshme të kualifikimit është me afat 3 mujor, ndërsa kërkesat e veçanta janë me afat deri 3 vjeçar. Sipas LPP, neni 46, pika 1, germa (ç), me rubrikën “kapacitet ligjor” nënkupton, që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi ose, në rastet e bashkimit të shoqërive, vërtetojnë se i gëzojnë këto aftësi në kohën e lidhjes së kontratës. Vendosja në këtë formë e kërkesave të veçanta të kualifikimit, nuk plotëson kërkesat e neni 46 të LPP, që OE të vërtetojnë se kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi ose, në rastet e bashkimit të shoqërive, vërtetojnë se i gëzojnë këto aftësi në kohën e lidhjes së kontratës.

Në disa raste konstatohet se si kriter i veçantë kualifikimi për “Kapacitetin ekonomik dhe financiar”, kërkohet “Kopje e deklaratave të xhiros vjetore për 3 vitet” kërkesë që nuk reflekton realisht kapacitetin financiar të operatorëve. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.18.47 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

Sa sipër rekomandoj:

Në çdo rast në hartimin e dokumenteve të tenderit, të analizohen dhe vendosen kritere të qarta për të vërtetuar “Kapacitetin ligjor të operatorëve ekonomikë”, zotësinë e tyre juridike për të lidhur kontrata prokurimi ose, në rastet e bashkimit të shoqërive, të vërtetojnë se i gëzojnë këto aftësi në kohën e lidhjes së kontratës.

Vazhdimisht

7. Konstatohet se janë përdorur disa prokurime me procedurë “Negocim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”, sidomos prokurimi me objekt “Ruajtja dhe Sigurimi Fizik i UMT” për tre vite si dhe në një rast “Prodhim i diplomave të studentëve të vitit 2014”. Për prokurimin me objekt “Ruajtja dhe Sigurimi Fizik i UMT”, janë zhvilluar brenda vitit 4 procedura të ndryshme, si fillim shtesë e kontratës 20%; vazhduar me dy herë procedurën “me negocim pa njoftim paraprak të kontratës”, dhe në përfundim me procedurën “e hapur”. Argumentimi i procedurës së mësipërme nga AK konsiderohet si nevojë në kushtet e emergjencës por legjislacioni mbi prokurimin publikon i përcakton qartë rastet e emergjencës.

-Vlerat e shtesave të kontratave në masën 20%, për tenderat me objekt “Ruajtjen e sigurisë fizike së objekteve”, të cilat kryheshin në fillim të vitit deri sa të zhvillohej procedura e prokurimit, nuk llogariteshin mbi vlerat e kontratave të lidhura gjatë vitit të kaluar por llogariteshin vetëm mbi vlerën e kontratës së fundit, në një kohë, që në disa raste, procedura e tenderit të fundit kishte vlerën shumë të vogël, për dy-tre muaj, çka e vinte në vështirësi këtë autoritet kontraktor. Kjo metodë si dhe mos fillimi i procedurave në fillim të çdo viti, ka bërë, që në këtë AK, të përdoret shpesh procedura “Me negocim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr. 18-47 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

Për sa sipër rekomandoj:

Të merren masa që prokurimet të zhvillohen brenda vitit buxhetor duke planifikuar saktë prokurimet me objekt “Ruajtja dhe sigurimi fizik i UMT”, sipas kërkesave të VKM nr. 914, datë 29/12/2014, ndryshuar, neni 36, në pikën nr. 2, germa “ë”.

Vazhdimisht

8. Nga auditimi i tenderit me objekt “Blerje diplomash për UMT” me fond limit total rreth 5,6 milion lekë, zhvilluar në vitin 2014, me procedurë “negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, dhe vlerë kontrate rreth 4,8 milion lekë, konstatohet se është argumentuar kushti i emergjencës me faktin e zhvillimit të grevës nga studentët duke u bërë problem mediatik, mungesa e këtyre diplomave. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.18-47 të Raportit Përfundimtar të auditimit, Sa sipër rekomandoj:*

Të ngrihet komision për të saktësuar nëse ka diploma gjendje/stok nëpër magazinat e fakulteteve. Në rast se verifikohet ky fakt, të merren masa për ti nxjerrë jashtë përdorimit diplomat e mbetura, dhe asgjësimi i tyre të ndiqet me rigozitet.

Menjëherë

II. Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe saktësisë së dokumentimit të vlerave monetare të kryera nëpërmjet pagesave të bankës.

9. Gjatë auditimit të dokumentacionit të kontabilizuar në ditarin e pagesave të bankës, rezultoi se likuidimet e kryera për shpenzimet: shërbim interneti; shërbim postar; shërbim për analiza mostre gazoili; shërbim sigurime & ruajtje roje; udhëtim studentor; aktivitet të ndryshme studentore; pritje e përcjellje, akomodim; taksa vendore; energji elektrike; komision bankar; shpenzime udhëtimi, biletë avioni; pjesëmarrje në Konferenca; abonim në gazeta dhe fletore zyrtare; transferata me jashtë (Pagesë Fee-je) pjesëmarrje në simpoziume; aplikim për akreditim kursi IBRO mbi neuroshkencat; printime & publikime, ndërtim, mirëmbajtje; shpenzim pastrimi & gjelbërimi; mirëmbajtje ndërtese; tarifë për regjistrim diplomash në MAS; etj. të kësaj natyre.

-Njësia shpenzuese ka kryer likuidime shpenzimesh për pritje e përcjellje dhe trajtim të delegacioneve të huaja si nga fakultetet dhe Rektorati, për të 3 vitet me një vlerë rreth 830 mijë lekë. Dokumentimi i këtyre shpenzimeve të kryera dhe të likuiduara nuk është bërë plotësisht konform legjislacionit në fuqi, pasi: jo në të gjitha rastet janë caktuar kategoritë e grupit të delegacioneve të huaja, pasi delegacionet e huaja për efekt të kuotës ditore të ushqimit dhe dhënieve të koktejeve janë të ndarë sipas rëndësisë në tre grupe, e kjo është e nevojshme për të audituar edhe zbatuar kuotat ditore të shpenzimeve; jo në të gjitha rastet janë caktuar numri dhe emrat e punonjësve, që shoqërojnë delegacionet e huaja, për të parë nëse është respektuar deri në dy fishin e palës pritëse ndaj palës së ftuar; nuk janë hartuar paraprakisht preventivat e shpenzimeve të trajtimit. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.11-14 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

Për sa sipër rekomandoj:

-Të bëhet kontabilizimi i dokumentacionit të pagesave të bankës për likuidime shpenzimesh të cilësuar më lart, duke reflektuar edhe në ditarin e regjistrimit të shpenzimeve.

-Titullari i Institucionit në programet e miratuara, për çdo pritje e përcjellje të delegacioneve të huaja, të shënojë kategoritë përkatëse të delegacioneve të huaja, emrat pjesëmarrës të tyre dhe të palës shqiptare duke respektuar raportin dy me një si dhe parapërgatitjen e preventivave të shpenzimeve të pjesëmarrjeve në lokalet përkatëse, sipas VKM nr. 243, datë 15/5/1998 “Për shpenzime për pritje, përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3/6/1999, për fiksime të kuotave.

Vazhdimisht

10. Për vitet 2014 -2015 janë likuiduar shpenzime për kafe, ujë, qumësht, etj. me vlerë totale prej rreth 138,000 lekë, me argumentin shpenzime për pritje të zyrtareve të huaj, por për to nuk ka të bashkëlidhur programe konkrete për pritje nëse janë shpenzime kuotash për të huaj apo për zyrtar shqiptar. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.11-14 të Raportit Përfundimtar të auditimit,*

Për sa sipër rekomandoj:

Nëpunësi Autorizues i Njësies Shpenzuese për të tilla shpenzime, detyrimisht të shoqërojë me programe pritje e koktej vetëm të zyrtarëve të huaj, duke vendosur edhe emrat e pjesëmarrësve të të huajve dhe të palës shqiptare, në të kundërtën vlerat e tilla konsiderohen dëm ekonomik për buxhetin, bazuar në VKM nr. 243, datë 15/5/1998 “Për shpenzime për pritje, përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.6.1999.

11. Gjatë 3 viteve (2014-2016) janë likuiduar shpenzime me vlerë rreth 9,2 milion lekë, që përfaqësojnë shpenzime për aktivitete të ndryshme studentore e pedagogjike si jashtë vendit ashtu edhe brenda vendit të miratuara me Vendim të Këshillit të Administrimit të UMT si dhe të Këshillit Studentor për të gjitha fakultetet e UMT, si: për shkolla dimërore; shkolla verore; transport studentor për projektin “Kanceri i gjirit parandalohet/blerje materialesh të ndryshme”; aktivitete mësimore e studentore “HIV-AIDS parandalohet”; muaji i Higjienës Orale, java e Hipertensionit Arterial; trajnime multidisiplinore klinike; duhani vret dhe lufta kundër kancerit gjinekologjik.

Këto shpenzime, nëpërmjet likuidimeve të bankës, janë shoqëruar me programet e punës dhe pasqyrat financiare të hartuar nga grupet organizativ të studentëve, por nuk janë bashkëlidhur praktikat e plota dokumentare të vërtetimeve të shpenzimeve, e sidomos listat e pjesëmarrësve të studentëve apo pedagogëve janë edhe fotokopje. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr11-14 të Raportit Përfundimtar të auditimit,*

Sa më sipër rekomandoj:

Nëpunësi autorizues, Nëpunësi Zbatues dhe Kontabilizuesi, përpara se të nënshkruajnë për pagesë, urdhër shpenzime të tilla, detyrimisht të jenë të plotësuar me dokumentacionin justifikues, të cilat vërtetojnë kryerjen në fakt dhe në mënyrë kronologjike të shpenzimeve faktike. Dokumentacioni do të quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative, madje edhe preventivat përkatës duhet të jenë analitike, pavarësisht së mund të ndodhen në dosjen e tenderave.

12. Konstatohet se janë kryer likuidime shpenzimesh për shërbime jashtë vendit, por praktikat dokumentare të pagesave nuk kanë bashkëlidhur dokumentacionin e plotë siç kërkon legjislacioni në fuqi, pasi në programet përkatëse nuk janë bërë të qarta nëse pala pritëse e ka ftuar apo shkon vetë për llogari të njësisë shpenzuese. Ftesat nuk janë të bashkëlidhur në urdhër shpenzimet përkatëse. Gjithashtu nuk janë nxjerrë rregulla të brendshme për organizimin e punës për sigurimin e hoteleve me kosto më të ulët. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.11-14 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

Sa më sipër rekomandoj:

UMT të tilla shpenzime, duhet ti konsiderojë të mirëqena, pasi ti jenë bashkëlidhur ftesat dhe shkresat përkatëse argumentuese. Njësia shpenzuese duhet të nxjerrë rregulla të brendshme për organizimin e punës për sigurimin e hoteleve me kosto më të ulët si dhe të hartojë praktika dokumentare si: dokumentet e “Urdhër shërbimit për jashtë vendit”, “Autorizim për shërbim jashtë vendit”, “Urdhër për shërbim jashtë vendit si dhe Urdhër “Për trajtim financiar të punonjësve, që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, etj. të përcaktuar qartë në VKM nr. 870, datë 14/12/2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” si dhe UMF/Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit nr. 22, datë 10/07/2013.

13. Nga auditimi i likuidimit të shpenzimeve për energji elektrike rezultoi se paguhej 6 muaj nga Rektorati dhe 6 muaj nga Fakulteti i Mjekësisë për vitin kalendarik sipas një marrëveshjeje verbale pasi janë në të njëjtën godinë. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.11-14 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

Sa më sipër rekomandoj:

Të merren masa për vendosjen e matësit elektrik për secilën njësi shpenzuese (Rektorati dhe Fakulteti i Mjekësisë), pasi secila ka buxhet më vete.

14. Me Urdhër shpenzim të vitit 2016, është likuiduar Studio Ligjore "K & H", me argumentim të kryerjes së shpenzimeve gjyqësore, 40.000 lekë, për të marrë dy avokat me qëllim përfaqësimi, sipas urdhrit nr. 1537, datë 23/6/2016, nr. 30, datë 23/6/2016, të nënshkruar nga Rektori A.Gj. me rastin e zgjedhjeve, për paditësin kandidati P.B.

Për këtë qëllim është lidhur kontrata e shërbimit datë 23/6/2016, me nr. 1537/2 me këtë studio avokatie, në një kohë që UMT ka në strukturën organike "jurist", si dhe përzgjedhja e kësaj studioje ligjore është bërë pa procedurë prokurimi. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.11-14 të Raportit Përfundimtar të auditivit).*

Për sa sipër rekomandoj:

Në rastet kur kërkohet shërbim i specializuar për përfaqësim ligjor i cili nuk mund të kryhet nga juristët e UMT që janë në strukturë, ky shërbim ti nënshtrohet legjislacionit të prokurimit publik.

Vazhdimisht

III. Mbi organizimin dhe funksionimin e auditimit të brendshëm.

15. Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka ushtruar auditim në njësinë shpenzuese vartëse Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, për vitin 2014 dhe Korrik-Dhjetor 2015, edhe pse ka përfunduar auditimi për vitin 2016. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr. 52-58 të Raportit Përfundimtar të auditivit).*

Sa më sipër rekomandoj:

UMT të përfshijë në planin e auditimeve të vitit 2017 edhe periudhat e kapërcyer duke mos lënë pa audituar periudhat e vazhdimësisë vitet 2016-2017.

Menjëherë

16. Njësia e Auditit të Brendshëm, ka konstatuar mangësi e shkelje në disa njësi shpenzuese vartëse të UMT, si në programimin dhe administrimin e buxhetit ku janë blerë bojëra printeri me vlerë rreth 64 mijë lekë, në një kohë, që nuk kanë në dispozicion as në inventarin e tyre të tillë si printera; mos pasjen në eficiencë të investimeve e projekteve për 2-3 vite, si të sistemit elektronik të evidencave me vlerë rreth 2 milion lekë si dhe instalimin e kamerave në vlerën rreth 790 mijë lekë, edhe pse janë kryer likuidimet, etj., por nuk kanë qenë të mjaftueshme rekomandimet për marrje të masave disiplinore apo vënien në ngarkim të personave përgjegjës të këtyre shpenzimeve të kryera pa efektivitet.

-Në planet vjetore, Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka parashikuar zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e kaluara, por janë mjaftuar duke e kryer zbatimin e tyre në auditimet e radhës. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.52-58 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

Për sa sipër rekomandoj:

Të merren masa që shkeljet dhe mangësitë e konstatuara nga Njësia e Auditit të Brendshëm ti vlerësojë dhe të marrë masa disiplinore si dhe të kërkojë shpërbllimin e dëmi ekonomik të shkaktuar në mënyrë që të ti shërbejnë përmirësimit të cilësisë së rezultateve në vitet pasardhëse të njërive shpenzuese (Fakulteteve). Gjithashtu të marrë masa në FMD, që të vendosë në implementim investimet e kryera për sistemin elektronik të investimeve dhe instalimin e kamerave në një kohë sa më të shpejtë si dhe të studiojë inventarizimet fizike të aktiveve të të gjitha fakulteteve vartëse, nëse ka në dispozicion printer për bojëra të tilla të mbetura stok po në FMD, duke u kaluar fakulteteve përkatëse, me qëllim të mos skadimit të afatit të tyre, në të kundërtën të dalë përgjegjësia me dëm ekonomik ndaj personave shkaktarë. Në planet vjetore të auditimit të parashikohen edhe zbatimi i rekomandimeve të lëna.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

17. Nga vlerësimi i auditit të brendshëm konstatohet se nga studimi dhe analizimi i materialeve të auditimeve të përgatitura nga Njësia e Auditit të Brendshëm, pothuajse në të gjitha njësitë shpenzuese vartëse (fakultetet), kanë rezultuar me mos kryerje të inventarizimeve të aktiveve dhe të mos krijimit të regjistrave të aktiveve, veprime të cilat janë detyrim të legjislacionit të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik për tu kryer çdo vit dhe për tu përditësuar vazhdimisht.

Nga verifikimi i bërë në Bibliotekën e Universitetit të Mjekësisë Tiranë konstatohet se është furnizuar në vitin 2008 me një sasi tituj librash të ndryshëm ish Fakultetin e Mjekësisë Tiranë, sot Njësi vartësie e Universitetit të Mjekësisë Tiranë (UMT), megjithëse janë gjendje në bibliotekë në ruajtje nga znj. L.P. Librat nuk janë bërë hyrje në magazinë dhe nuk ka dokument si “Mall në ruajtje”. Tërheqja e librave është bërë pa pasur më parë listën e miratuar nga departamentet përkatëse të këtij fakulteti dhe pa përdorur procedurë prokurimi.

Sa më sipër UMT-ja përmes Njësisë së Auditit të Brendshëm ka verifikuar dhe në përfundim ka konkluduar se librat janë gjendje në bibliotekë dhe ka dhënë masë disiplinore për punonjësen e bibliotekës. (*Trajtuar më hollësisht në faqen nr58-59 të Raportit Përfundimtar të auditivit*).

Për sa sipër rekomandoj:

-Rektorati i UMT, me urdhër të brendshëm të kërkojë nga njësitë shpenzuese vartëse, që të ngrihen komisionet përkatëse për të kryer inventarizimet fizike të aktiveve, natyrisht duke i rakorduar edhe me kontabilitetin e tyre si dhe të krijimit të regjistrave kontabël të aktiveve duke u mbajtur në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar si dhe si dhe përditësimin e regjistrave kontabël të të gjitha aktiveve, që zotëron apo kanë në administrim. Kjo në saktësimin e inventarëve të aktiveve, meqenëse nga 5 fakultete, që kanë pasur në funksionim, janë mbyllur dy fakultete, duke mbetur në funksionim 3 fakultete, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Të bëhet likuidimi i vlerës përkatëse Dyqanit të “L.U.”.

Menjëherë

18. Nga auditimi mbi ***krijimin dhe përdorimin e të ardhurave*** që realizon institucioni, konstatohet se në referim të ligjit në fuqi të periudhës që i përket ky auditim, konkretisht Ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” me ndryshime, në nenin 74/2 përcaktohet që “...*Të ardhurat e krijuara sipas pikës 1 të këtij neni derdhen 100 për qind në llogarinë e institucionit dhe përdoren nga vetë ai, sipas rregullave të përcaktuara*”. Për mënyrën e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat, institucionet publike të arsimit të lartë bëjnë rregulloret e tyre duke respektuar rregullat financiare të përcaktuara nga ligjet e shtetit.

Me Vendimin nr. 5, datë 02.4.2014 të Këshillit të Administrimit (KADM), është vendosur transferimi në Rektorat deri në masën 10% i të ardhurave nga Fakulteteve të UMT-së. KADM-i nuk ka përcaktuar në këtë vendim, mënyrën e përdorimit të të ardhurave, duke mos respektuar kërkesat e nenit 73/3 të Ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 me ndryshime si dhe të vetë Statutit të UMT-së, neni 88 sipas të cilit “..... Mënyra e përdorimit të të ardhurave nga UMT-ja, njësitë kryesore e deri nga shërbimet përcaktohen në rregulloren e brendshme për administrimin, financiar dhe kontabilitetin”. Një rregullore e tillë nuk është miratuar nga UMT dhe nuk u vu në dispozicion të grupit të audituesve gjatë kohës së auditimit.

Gjithashtu për periudhën korrik 2015 dhe viti 2016, nga Bordi i Administrimit nuk është miratuar asnjë vendim për përdorimin e të ardhurave, duke vepruar në këtë mënyrë në kundërshtim me nenin 109, pika 3 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. *Trajtuar më hollësisht në faqen nr. 48-49 të Raportit Përfundimtar të auditimit*,

Për sa sipër rekomandoj:

UMT të marrë masa që në zbatim të Statutit të miratojë Rregulloren e brendshme për administrimin, financat dhe kontabilitetin ku të parashikojë dhe mënyrën përdorimit të këtyre të ardhurave bazuar në nenin 109, pika 3 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Menjëherë

19. Nga auditimi mbi ***Funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit***, konstatohet se Rregullorja e brendshme nuk është përditësuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 80/2015,

datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSh”. (Trajtuar më hollësisht në faqen nr. 51-52 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

Sa sipër rekomandoj:

Të hartohet dhe miratohet menjëherë Rregullorja e Brendshme e UMT-së, e cila të reflektojë kërkesat e ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015.

Menjëherë

6. Të tjera:

Punonjësi A.O.Rr. me detyrë specialist Hidraulik dhe Kaldajist në UMT, larguar nga puna.

Punonjësi në fjalë është larguar nga puna me datën 31/12/2016. Mbas diskutimeve me këtë punonjës dhe stafin drejtues të UMT, rezultoi se ai ka qenë i komanduar dhe me kontratë deri 31/12/2016. Me fillimin e vitit 2017 organika është shkurtuar, megjithatë me datën 03/03/2017 nga ana e Rektorit të UMT i është dhënë shkresa për të rifilluar punë në Fakultetin e Infermierisë, shkresë të cilën e disponon edhe ankimuesi.

Sa sipër rekomandoj:

Në lidhje me këtë konstatim nuk jepet rekomandim pasi problemi është zgjidhur gjatë periudhës së auditimit. (Trajtuar më hollësisht në faqen nr. 59-60 të Raportit Përfundimtar të auditimit,

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Të kërkohet në rrugë ligjore/administrative vlera e dëmit ekonomik **270,373 lekë**, nga operatori ekonomik “A.”, pasi nga auditimi i procedurës së tenderit me objekt “Rikonstruksion i ambienteve të Fakultetit të Mjekësisë Dentare”, zhvilluar në vitin 2015, është konstatuar se në preventivin që shoqëron ofertën, është përfshirë pa të drejtë vlera e TVSH-së për “Pajisjet”, në kundërshtim me DST, UKM nr. 2, datë 8.5.2003, Kreu I/I, germa A/7, si dhe me UKM nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001, të ndryshuar, pika 1, germa “c”, paragrafi i fundi. Gjithashtu të kryhet kontabilizimi i vlerës së dëmit dhe të bëhet arkëtimi i tij. (Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqen nr. 18-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Brenda datës 30 Qershor 2017

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 12 e 72/2 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i rekomandojmë Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të analizohet Raporti Përfundimtar i Auditimit, të nxirren përgjegjësitë për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në fushën e prokurimeve publike, nga punonjësit si më poshtë:

1. A.C. Përgjegjëse e Sektorit të Prokurimeve Publike dhe anëtare e NJP pjesëmarrëse në 7 tendera si dhe anëtare e komisionit të përlllogaritjes së fondit limit pjesëmarrëse në 4 tendera;
2. E.Sh. anëtare e NJP, pjesëmarrëse në 7 tendera;
3. T.K. Drejtore e Drejtorisë Ekonomike, anëtare e NJP pjesëmarrëse në 6 tendera si dhe anëtare e komisionit të përlllogaritjes së fondit limit pjesëmarrëse në 1 tender;
4. E.H. anëtar i NJP pjesëmarrëse në 8 tendera;
5. A.K. anëtar i NJP pjesëmarrëse në 5 tendera;
6. S.H. anëtar i NJP pjesëmarrëse në 2 tendera si dhe pjesëmarrës në komisionin e përlllogaritjes së fondit limit në 2 tendera;
7. E.K. anëtare e NJP pjesëmarrëse në 1 tender si dhe anëtare e komisionit të përlllogaritjes së fondit limit në 2 tendera;
8. M.F. anëtare e komisionit të përlllogaritjes së fondit limit, pjesëmarrës në 8 tendera, të cilët nuk kanë vepruar konformë legjislacionit të prokurimeve publike në fuqi, si: në hartimin e regjistrave të parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike, të cilët nuk janë bërë nga Përgjegjësjë e Sektorit të Prokurimeve konform formateve të miratuara të APP-së; nuk janë hartuar e vendosur kërkesat kualifikuese të veçanta, të rubrikës së kërkesës kualifikuese “Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë” si dhe rubrikës “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, për vërtetimin

“Kopje të deklaratave të xhiros vjetore për 3 vitet” pa vendosur vlerat si dhe pa caktuar nëse duhen vlera mesatare e tri viteve apo vlera për çdo vit si dhe nuk kanë bërë argumentimet e vendosjeve të kërkesave kualifikuese të veçanta, nga njësitë e prokurimit publik. Gjithashtu nuk janë lënë gjurmë të plota për përlogaritjet e fondeve limite nga komisionet përkatëse.

D. PËR KLSH.

Auditimi i kryer në Universitetin e Mjekësisë Tiranë vlerësohet dobët nga Kryetari i KLSH dhe për të kontrolluar cilësinë e punës auditueses do të riauditohet në një kohë të dytë ose do të vazhdoj direkt me kontroll të nxehtë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim, ngarkohen Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R